



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 76

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Prishtinë, më 24 korrik 2013, në orën 13:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Bahri Thaçi, Salihe Mustafa, Gëzim Kelmendi, Nazane Breca.

Munguan: Liburn Aliu dhe Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit, Xheneta Sopjani, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 10.07.2013;
3. Shqyrtimi i projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;
4. Shqyrtimi i raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, nr. 03/L-019;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 10.07.2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së datës 10.07.2013.

Fikrim Damka- Propozoi që fillimisht të shqyrtohet pika e katërt e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, nr. 03/L-019

Fikrim Damka – Tha se deputetja Flora Brovina ka qenë kryesuese e grupit punues dhe ia dha fjalën.

Flora Brovina- Tha se grupi punues ka vizituar të gjitha qendrat e punësimit dhe riaftësimit profesional për personat me nevoja të veçanta. Kemi marrë edhe një propozim nga HANDIKOS, që të ndryshohet neni 12.2 i ligjit, si vijon:

Çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo njëzet e pesë (25) punëtorë. Kjo duke u bazuar në faktin se në Kosovë ka më shumë ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

HANDIKOS-i propozon gjithashtu që të rritet përqindja e shumës së të hollave që duhet të ndajnë ndërmarrjet të cilat nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuara.

Disa nga vërejtjet e gjetura në terren janë: pamundësia e qasjes së personave me aftësi të kufizuara në objekte, një ndër to është edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe shtimi i profileve në qendrat e riaftësimit profesional.

Salihe Mustafa- Tha se sa i përket qendrave të aftësimit profesional, projektligji që e kemi tash për Agjencinë e Punësimit, parasheh që këto qendra të kalojnë në menaxhim të kësaj agjencie, dhe gjatë shqyrtimit, e kemi mundësinë që të propozojmë për të shtuar numrin e qendrave të riaftësimit profesional, si dhe llojllojshmërinë e profileve.

Time Kadrijaj – Përkrahu miratimin e raportit të monitorimit dhe tha se është bërë një punë e mirë nga grupi punues dhe raporti duhet të dërgohet për miratim në seancë.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri miratoi raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/ L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti

Fikrim Damka- Tha se kanë ardhur disa rekomandime nga komisionet e përhershme për Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka propozuar që të fshihen amendamentet: 1, 9,10,11,19 dhe 20.

Komisioni për Legjislacion ka propozuar tri amendamente: Të riformulohet neni 8, paragrafi 1.2, gjithashtu neni 8, paragrafi 2 dhe neni 12, paragrafi 2.

Edhe Komisioni për Integritet Evropian ka propozuar një amendament: Në nenin 8, pas paragrafit 5, të shtohen dy paragrafë.

Deputetët, Flora Brovina, Nazane Breca, Salihe Mustafa dhe Gëzim Kelmendi, propozuan që të ftohet kryetari i Komisionit për Legjislacion, që të diskutohen amendamentet e propozuara.

Pas diskutimeve, Komisioni miratoi të gjitha amendamentet e propozuara në raportin e mëhershëm dhe nuk u përkrahën propozimet e Komisionit për Buxhet, që të fshihen amendamentet: 1, 9,10,11,19 dhe 20.

Për amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion, Komisioni vendosi të ftojë ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe kryetarin e Komisionit për Legjislacion, që të diskutohen këto amendamente.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka